



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 281/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziq dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit Vakati në Prizren, paraqitur kundër Nova Demokratska Stranka, në Prizren, për shkak të vendosjes mbulimit të posterit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Koalicioni Vakati, dega në Prizren, kështu që Nova Demokratska Stranka, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 400 (katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.10.2013, nga Kooalicioni Vakati, me të cilën pretendohet se anëtarë të subjektit politik NDS, në Prizren më datë 16.10.2013 kanë vendosur posterat e tyre në xhamat e zyrës e cila zyrtarisht është selia e Koalicionit Vakati

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik NDS në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr. 281/2, PZAP-nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik NDS, të cilën do të sqaronte se a është e vërtetë se posterat e tyre gjinden në selinë e koalicionit Vakati

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e NDS-së janë të vendosur në selinë e Koalicionit Vakut, e që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.
- Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtuesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat e NDS-së, janë të vendosur në xhamat e selisë së Koalicionit Vakut të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese morri se NDS ka marrë pjesë edhe më herët në Zgjedhje Lokale ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se, NDS është hera e parë që ka bërë shkelje të kësaj natyre për këto Zgjedhje Lokale.

Andaj, duke marrë parasysh se nga ana e NDS-së është shkelur neni 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e NDS janë vendosur në Xhamat e selisë së Koalicionit Vakut, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në Zgjedhje Lokale, Rregulla nr. 1 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë*

*është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 281/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.